



**LINJA KOMBËTARE E NDIHMËS PËR
FËMIJËT**
Albanian National Child Helpline

RAPORT TEMATIK

Dhuna tek fëmijët vajza



Tiranë, 25 Nëntor 2013



**LINJA KOMBËTARE E NDIHMËS PËR
FËMIJËT
Albanian National Child Helpline**

RAPORT TEMATIK

Dhuna tek fëmijët vajza

**Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër
dhunës me bazë gjinore**

Me mbështetjen e:



Tiranë, 25 Nëntor 2013

Pasqyra e raportit

- 1. Koncepti i dhunës me bazë gjinore**
- 2. Incidenca dhe Prevalenca e Abuzimit Seksual të Fëmijës**
- 3. Aborti selektiv i fëmijëve vajzave në Shqipëri**
- 4. Studimi B.E.C.A.N dhe dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri**
- 5. Të dhëna nga Alo 116 mbi dhunën ndaj fëmijëve vajza**
- 6. Histori të dhunës me bazë gjinore të raportuara në ALO 116**
- 7. Referanca**

1. Koncepti i dhunës me bazë gjinore



Koncepti i dhunës ndaj fëmijës: dhunë ndaj fëmijës (kundër fëmijës) do të konsiderohen të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimi seksual, neglizhimi ose trajtimi neglizhues a shfrytëzimi për qëllime përfitimi ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëmtim të vërtetë ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti¹.

Koncepti i dhunës me bazë gjinore: do të konsiderohet çdo veprimi i dhunshëm i ndërmarrë përkundrejt një personi duke u bazuar në gjininë e tij/saj, pa vullnetin dhe pëlqimin e personit, që prek zhvillimin, shëndetin fizik e psikik, si dhe identitetin e atij personi².

¹World Report on violence and health, Etienne G.Krug,Linda L.Dahlberg, James A.Mercy, Anthony B.Zwi and Rafael Lozano, World Health organization, Geneve,2002, f. 84.

²World Report on violence and health, Etienne G.Krug,Linda L.Dahlberg, James A.Mercy, Anthony B.Zwi and Rafael Lozano, World Health organization.

2. Incidenca dhe Prevalenca e Abuzimit Seksual të Fëmijës

Përkufizimi i Abuzimit Seksual të Fëmijës

Çdo ekspozim i qëllimshëm i fëmijëve ndaj një aktiviteti seksual, ose përdorimi i fëmijëve për qëllime seksuale (Stevens, 2002) përbën abuzim seksual të fëmijës.

Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (1989), "fëmijë" konsiderohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç. Abuzimi seksual i fëmijës përfshin përkedheljen, masturbimin, kontaktet orale, vaginale ose anale. Është shumë e rëndësishme të kuptohet që, në rastin e abuzimit seksual të fëmijës, nuk është e domosdoshme që të ndodhë penetrimi seksual. Përdorimi i fëmijës për prostitucion, pornografi apo ekzibicionizëm janë shembuj të tjerë të abuzimit seksual të fëmijës. Abuzuesi mund të jetë një i njohur ose i panjohur për fëmijën.

Në ndryshim nga marrëdhëniet e inçestit, sindroma e fëmijës së abuzuar seksualisht nuk ishte e njohur saktësisht deri nga fundi i vitit 1970. Literatura mjekësore deri në mesin e vitit 1970, përmbante shumë artikuj për fëmijët dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si psh gonorea. Megjithatë, nuk diskutohej asgjë lidhur me origjinën e këtyre sëmundjeve. Në atë kohë, vihej re një hezitim i madh i shoqërisë për t'u përballur me këtë çështje. Vetëm pas tre dekadash ekzaminimesh mbarë botërore, abuzimi seksual i fëmijës po konsiderohet tashmë si çështje serioze (Goldenring, 2005).

Është e vështirë të përcaktohet qartë incidenca e abuzimit seksual. Kjo ndodh sepse në përgjithësi, abuzimi seksual i fëmijëve është shumë më i fshehtë, ose më pak i raportuar sesa ai fizik. Nga ana tjetër, edhe mënyra sesi përkufizohet abuzimi seksual i fëmijës mund të ndikojë numrin e njerëzve që e kanë përjetuar atë. Për shumë vajza të reja, dhuna seksuale fillon në adoleshencë apo dhe më herët në fëmijërinë e tyre. Në disa vende të botës, gati 1/3 e vajzave adoleshente raportojnë fillim të dhunshëm të marrëdhënieve seksuale³ (Studimi WHO, 2002)

Në dekadat e fundit disa forma ekstreme të dhunës ndaj fëmijëve, duke përfshirë këtu shfrytëzimin seksual dhe trafikimit, gjymtimi gjenital femëror (FGM), format më të këqia të punës së fëmijëve dhe ndikimin e konfliktit të armatosur, kanë shkaktuar zemërim ndërkombëtar dhe është arritur në një konsensus për dënimin e këtyre formave të dhunës, edhe pse nuk ka ilaç të shpejtë. Por, përveç këtyre formave ekstreme të dhunës, shumë fëmijë

³ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Letra e Fakteve mbi Dhunën dhe Neglizhencën tek Fëmijët, Gjenevë 2002.

janë të ekspozuar në mënyrë rutinore ndaj dhunës fizike , seksuale dhe psikologjike në shtëpitë dhe në shkollat e tyre, në sistemet e kujdesit dhe drejtësisë, në vendet e punës dhe në komunitetet e tyre. E gjithë kjo ka pasoja shkatërruese për shëndetin e tyre dhe mirëqenien, tani dhe në të ardhmen⁴.

Përsa i përket shkaqeve të dhunës me bazë gjinore, në vitin 2006, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara prezantoi ' Një studim të thelluar të të gjitha formave të dhunës kundër grave " në Asamblenë e Përgjithshme. Ai theksoi shkaqet strukturore dhe sistematike të dhunës mashkullore ndaj grave dhe vajzave, faktorët e rrezikut që rrisin vulnerabilitetin e tyre dhe faktorët që formësojnë eksperiencat e tyre personale të dhunës (Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara 2006a : 11).

Abuzimi seksual, dhuna fizike, psikologjike dhe ngacmimi seksual janë forma të dhunës që ndodhin në të gjitha mjediset. Në shumicën e shoqërive, abuzimi seksual i vajzave dhe djemve është më i përhapur brenda mureve të shtëpisë ku dhunimi është kryer nga një person i njohur të familjes. Dhuna seksuale gjithashtu ndodh në shkolla dhe mjedise të tjera arsimore, nga nxënësit e tjerë të klasës ose të shkollës ose dhe nga vetë mësuesit. Një formë tjetër e dhunës është dhe punësimi i fëmijëve. Vajzat vuajnë në mënyrë të konsiderueshme më shumë nga shuna seksuale se sa djemtë, dhe vulnerabiliteti i tyre ndaj kësaj forme të dhunës në shumë rrethana është në masën më të madhe një produkt i ndikimit të marrëdhënieve të pushtetit me bazë gjinore në shoqëri.

Sesioni i 51 i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Statusin e Grave (26 shkurt - 7 mars 2007) mori si temë të saj prioritare , "eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës ndaj vajzave ". Nisur nga progresi dhe rishikimin e Platformës për Veprim të Pekinit të viti 1995 Shtetet Anëtare kanë raportuar se edhe pse kishte pasur progres, veçanërisht në lidhje me miratimin e legjislacionit, mbrojtja e të drejtave të vajzave nuk kishte pësuar mjaftueshëm ndryshim. Vëmendje i është tërhequr jo vetëm për vazhdimin e praktikave të dëmshme tradicionale, duke përfshirë FGM / C dhe martesat të detyruara, por edhe për faktin se vajzat ishin veçanërisht të rrezikuara nga abuzimi seksual, shfrytëzimit seksual dhe trafikimit, duke përfshirë këtu kohën e ndodhjes së konfliktit por edhe periudhën pas ndodhjes së konfliktit⁵

⁴Paulo Sérgio Pinheiro, Raporti Bpterior mbi Dhunen ndaj Femijeve, Organizata e Kombeve te Bashkuara, Gjeneve 2006.

⁵Studim mbi Dhunen ndaj Vajzve,,Raport i Konferencesmbi Femijet Vajza, Innocenti Research Center, 2009.

3. Përmasat e abuzimit seksual të fëmijëve



Nuk është e lehtë të përcaktosh përmasat e fenomenit të abuzimit seksual të fëmijëve. Ndërsa raportimi i dhunës nga gratë në moshë madhore që kanë aftësi kognitive të tilla për të kuptuar kufijtë e “sjelljes normale” është ende shumë i vogël për shkak të faktorëve të përmendur më sipër, raportimi i dhunës seksuale nga fëmijët bëhet dyfish i vështirë (Ezzati et al., 2004, cituar nga Pinheiro,.)

Raporti Botëror i OKB-së për Dhunën ndaj Fëmijëve (2006) dhe i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) vlerësojnë se mbi 150 milion vajza dhe 73 milion djem nën moshën 18 vjeç kanë përjetuar një marrëdhënie seksuale me forcë ose forma të tjera të dhunës seksuale gjatë vitit 2002 (Ezzati et al., 2004, cituar nga Pinheiro, 2006). Dhuna seksuale ndikonte kryesisht tek ata që kishte arritur moshën e pjekurisë seksuale ose atë të adoleshencës, ndërsa vajzat ishin në rrezik më të madh të dhunës seksuale se sa djemtë⁶.

Pereda et al. (2009) zhvilloi një meta-analizë të studimeve në 65 raste të abuzimit seksual dhe prevalencës tek fëmijët në 22 vende⁷. Analiza tregoi se 7.9% e meshkujve dhe 19.7% e femrave kishte vuajtur një formë të abuzimit seksual para moshës 18 vjeç. Në përgjithësi, shkalla më e lartë e prevalencës së abuzimit seksual të fëmijëve (34.4%) raportohet në Afrikë

⁶Protecting Children from Sexual Violence- A comprehensive approach. Council of Europe, 2010. (Overview of the nature and extent of child sexual abuse in Europe, Kevin Lalor and Rosaleen McElvaney, School of Social Sciences and Laë, Dublin Institute of Technology.)

⁷ Idem

(Maroku, Tanzani, Afrika e Jugut). Europa tregoi normat më të ulta të prevalencës (9.2%). Amerika, Azia dhe Oqeania kanë një shkallë të prevalencës midis 10.1% dhe 23.9%.

Sipas një studimi mbi fëmijët të moshave 6-12 vjeç dhe 13-18 vjeç të kryer nga Qendra e Trajtimit Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimit të fëmijëve (2003), 11% e fëmijëve kishin patur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në mjedisin familjar; 4% e fëmijëve pranuan përjetimin e dhunës seksuale (Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2005).

Ndërsa sipas një studimi mbi profilin e fëmijëve shqiptarë të dhunuar, të kryer nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) me Qendrën e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (IRCCRA), rezulton se 3% e fëmijëve të dhunuar të strehuar në Strehëzën e Tiranës, janë abuzuar seksualisht përfshi këtu ngacmimet seksuale nga babai.

4. Aborti selektiv ndaj fëmijëve vajza në Shqipëri

Familjet shqiptare tradicionalisht kanë favorizuar djemtë mbi vajzat për dy arsye kryesore: trashëgimia e familjes dhe shpresa që djemtë të rriten për t'u bërë mbajtës të familjes” Në një shoqëri konservatore siç është e jona, familjet dëshirojnë trashëgimtarë meshkuj.


Ndryshe nga legjislativiteti komunist që ndalonte abortin , ligji i ri për shëndetin riprodhues, i hartuar në vitin 2002, ndalon përdorimin e teknologjisë riprodhuese për ofrimin e aborteve për shkak të përzgjedhjes së gjinisë.Në ligj parashikohet ndërprerja vullnetare e shtatëzanisë, me kërkesën e nënës deri në 12 javë shtatëzanie periudhë në të cilën nuk dallohet ende gjinia e fëmijës.

Megjithatë, përkundër këtij ligji, media dhe mjekët raportojnë se abortet e përzgjedhjes së gjinisë janë dukuri e përhapur dhe se numri i aborteve selektive është i madh. Në Rezouten 1829 të Këshillit të Europës të vitit 2011, Asambleja Parlamentare e tij ngriti për herë të parë shqetësimin e saj publik se përdorimi i abortit selektiv në vende si Shqipëria po krijonte një

mungesë të balancës gjinore natyrale. Sipas raportit në Shqipëri ratio midis femijeve të lindur është 112 djem për 100 vajza, që nuk përkon me balancën natyrale gjinore të popullësisë⁸.

Kjo konfirmohet edhe nga të dhënat e Census 2011 në Shqipëri, ku diferenca midis lindjeve djem-vajza duket qartë duke filluar që nga viti 2000 e në vazhdim. Tabela më poshtë tregon lindjet sipas gjinisë nga viti 2000-2012⁹.

Vitet	Meshkuj	Femra
2000	26,686	24,556
2001	27,986	25,219
2002	22,369	20,158
2003	23,834	21,479
2004	21,765	19,224
2005	20,616	18,282
2006	19,130	16,761
2007	18,327	16,121
2008	17,625	15,820
2009	18,080	16,034
2010	18,063	15,998
2011	17,849	16,436
2012	18,384	16,911



⁸Rezoluta 1829 e AsamblesëParlamentaretëKëshillittëEuropës, mundtëlexohetnëkëtë link:

<http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta11/ERES1829.htm>

⁹Census 2011 <http://ëë.instat.gov.al/themes/popullsia.aspx>

Nga tabela e mësipërme (të dhëna zyrtare të marra nga INSTAT) shohim se në cdo vit numri i lindjeve të fëmijëve djem është disa herë më i madh se ai atyre vajza, çfarë mund të na çojë në konkluzionin se preferenca për të pasur djem në famijen shqiptare është më e madhe se për fëmijët vajza. Kjo në vetëvete përbën një shqetësim si përsa i përket politikave të mbrojtjes së fëmijëve vajza ashtu edhe zbatimit të legjislacionit për ndalimin efektiv të abortit selektiv.

5. Studimi B.E.C.A.N dhe dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri

Studimi B.E.C.A.N i zbatuar nga CRCA Shqipëri, është një nga studimet më të mëdha të zhvilluara ndonjëherë në Europë dhe në rastin e Ballkanit mbulon një kampion prej afërsisht 30.000 fëmijë dhe prindër. Studimi epidemiologjik B.E.C.A.N i cili u zbatua në nëntë vende të rajonit të Ballkanit; Greqi, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Shqipëri, Bullgari, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Turqi dhe Rumania hartëzon shkallën e veprimit dhe përhapjen e keqtrajtimit në popullsinë e përgjithshme të fëmijëve nga mosha 11 deri në moshën 16 vjeçare që ndjekin shkollën, por edhe që e kanë braktisur atë¹⁰.


Nëse i shohim të dhënat të ndara sipas gjinisë, shohim se vajzat raportojnë dhunë psikologjike më të lartë sesa djemtë, (70% prevalencë/63% incidencë) ndërkohë që djemtë raportojnë (67% prevalencë dhe 60% incidencë).

Në lidhje me dhunën fizike të dhënat nuk paraqesin ndonjë ndryshim thelbësor midis viktimizimit midis djemve dhe vajzave (prevalence; 61% e vajzave dhe 58% e djemve). Ndërkohë incidenca raportohet në 49% tek vajzat dhe 48% tek djemtë). Në lidhje me ndjesinë e neglizhencës raportohet më shumë tek vajzat sesa tek djemtë. Prevalenca tek vajzat është 31% ndërkohë që raportohen vetëm 20% tek djemtë. Ndërkohë që incidenca është 27% tek vajzat dhe 16% tek djemtë¹¹.

¹⁰ Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B. (2013), Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Studimi Epidemiologjik në Ballkan mbi Abuzimin e Fëmijëve dhe Neglizhencën (BECAN), CRCA Albania, Tirana.


¹¹ Idem

Incidenca dhe prevalenca e ekspozimit të fëmijëve nda dhunës



Dhuna psikologjike është forma e dhunës që raportohet më së shpeshti nga fëmijët. Rreth 61,69% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës psikologjike të paktën një herë në jetën e tyre (prevalenca), dhe 68,63% e fëmijëve raportojnë të kenë një përvojë nga sjelljet që bien në kategorinë e dhunës psikologjike gjatë vitit të kaluar. Forma tjetër që raportohet më së shpeshti është dhuna fizike. Rreth 48,42% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar të paktën një formë e dhunës fizike gjatë jetës së tyre (prevalenca), dhe 59,45% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike gjatë vitit të kaluar (incidenca).

Ndjenjat e neglizhimi raportohet gjithashtu nga 21,87% e fëmijëve, të cilët deklarojnë se kanë përjetuar të paktën një herë në jetën e tyre një formë neglizhence, ndërkohë që 25,75% e fëmijëve e kanë përjetuar atë gjatë vitit të kaluar. Ngacmimi seksual dhe dhuna me kontakt seksual raportohet nga fëmijët në një masë që duhet të përbëj shqetësim publik. Kështu, 11,4% dhe 4,88% e fëmijëve deklarojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual dhe dhunë seksuale me kontakt respektivisht një herë gjatë jetës së tyre, ndërsa 9,15% dhe 4,10% e fëmijëve raportojnë se e kanë përjetuar atë gjatë vitit të kaluar.



6. ALO 116 dhe dhuna tek fëmijët vajza në Shqipëri

ALO 116: Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët (ALO 116) është një shërbim që ka për qëllim të ndihmojë fëmijët përmes asistencës në raste të emergjencës, këshillimit me telefon dhe referimit të rasteve tek shërbimet e institucioneve publike dhe joqeveritare që punojnë për fëmijët.

ALO 116 mbështetet nga UNICEF dhe CRCA Shqipëri. ALO 116 ofron shërbim 24 orë në ditë përgjatë 7 ditëve të javës dhe është në dispozicion të të gjithë fëmijëve në Shqipëri. Pranë ALO 116 fëmijët dhe prindërit mund të marrin informacion si dhe të raportojnë rastet e fëmijëve të humbur, të raportojnë raste të dhunës dhe keqtrajtimit të fëmijëve në familje, shkollë ose komunitet; të kërkojnë këshillimin për marrëdhëniet ndër-personale midis fëmijëve apo të informohen për çështje të cilat fëmijët i konsiderojnë të rëndësishme. Çdo fëmijë telefonon falas në ALO 116 faqë mbështetjes me telefonata falas nga të gjitha kompanitë e telefonisë celulare dhe fikse në Shqipëri.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga telefonatat që fëmijët kanë kryer pranë ALO 116 dhe rasteve të rregjistruara, ajo që mund të thuhet është se numri i telefonata, në lidhje me dhunën ndaj fëmijëve vajza, ka qënë relativisht i lartë. Ky është një tregues se shërbimi është i aksesueshëm për fëmijët në të gjitha zonat e Shqipërisë, qofshin ato urbane apo rurale. Nisur nga të dhënat e raportuara pranë ALO 116 kemi një rezymë të të gjitha rasteve të trajtuara pranë ALO 116 ndër vite, të dhëna këto që lidhen specifikisht me dhunën ndaj fëmijëve të gjinisë femërore.

Vajzat telefonojnë pranë ALO 116 histori të tyre të dhunës dhe se si ato trajtohen ndryshe nga djemtë e familjes. Shpesh herë ato detyrohen të kryejë punë shtëpie, të rrisin vëllezerit ose motrat më të vegjël. Ato jo rrallë herë ndërpresin studimet për shkak të gjinisë së tyre, nga frika që kanë prindërit se mos djemtë mund ti ngacmojë dhe si pasojë i detyrojnë të fejohen dhe të martohen që në moshë shumë të vogël. Të rritura nën hijen e nështrimit në familjen e tyre shkojnë dhe nënshtrohen gjithashtu edhe në familjet ku i martojnë prindërit.

Marrëdhëniet vëllazërore gjithashtu janë një tjetër element që tregon se meshkujt e familjes kanë më tepër të drejta kundrejt vajzave, shpesh herë ata abuzojnë fizikisht mbi motrat me pretendimin se janë djem dhe se fjala e tyre ka më tepër rëndësi se e vajzave.

Nga raportimet e fëmijëve mund të themi se këto fenomene nuk ndodhin vetëm në zonat rurale por dhe në zonat urbane.

Tabela më poshtë tregon llojet më të shpeshta të abuzimeve të vajzave e paraqitur dhe në përqindje për secilën kategori. Shohim se gjatë 2010 një përqindje të lartë zënë dhe abuzimi fizik , emocional, seksual dhe neglizhimi. Shifra të tilla brenda një viti janë vërtet domethënëse për një shoqëri me një popullsi jo shumë të madhe sic është Shqipëria. Prindër, mësues, por edhe persona të tjerë të rritur zgjedhin dhunën si një mënyrë ndëshkimi ndaj fëmijëve duke besuar se kjo është e vetmja mënyrë më efikase për ta bërë fëmijën të bindet dhe të mësojë nga gabimet. Dëmtimi i një zhvillimi normal emocional, fizik dhe psikologjik i këtyre fëmijëve është i pa shmangshëm. Duhet kuptuar se fëmijët nuk janë kukulla që të rriturit tëmund ti drejtojnë si duan. Ata janë qenie njerëzore që kanë nevojë tu respektohen të drejtat e tyre. Nevoja për respektimin e këtyre të drejtave i bën këta fëmijë që tëkërkojnë ndihmë pranë ALO 116. Abuzimi seksual është një tjetër shqetësim madhor, ku fëmijët vajza shfrytëzohen nga të rritur të njohur ose të panjohur.

PROBLEMI I RAPORTUAR	Viti 2010	PROBLEMI I RAPORTUAR	Viti 2010
Abuzimfizik	109	Mundesipunesimi	2
Abuzimseksual	34	Ndihmëfinanciare/materiale	0
Abuzimemocional	51	Probleme me miqtë	109
Neglizhim	53	Probleme me partnerin	632
Dëshmitardhune	17	Probleme me mësuesit	36
Bulizëm	131	Problemetëtjera me tërriturit	22
Dhunënfamilje	157	Ankth I performancës	8
Punë e detyruar	0	Braktisje e shkollës	8
Punë e fëmijesnështëpi	12	Marrëdhënieprind-fëmijë	127
Shfrytëzimseksual	1	Vetmi	19
Trafikim I fëmijës	1	Frike/ankth	0
Punëtëtjerratëfëmijëve	0	Vetedëmtim	1
Fëmijëtëpërdorur për lypje	4	Paragjykim	2
Fëmijë I humbur	2	Racizëm	0

Paraqitja grafike e formave të abuzimit për vitin 2010

Viti 2010




Tabela më poshtë tregon llojet më të përhapura të dhunës te fëmijët vajza gjatë vitit 2011, nga ku shohim se problemet me partnerizënë 35% të rasteve, problemet me miqtë 19% dhe marrëdhënia prind-fëmijë 19 %. Shohim se vajzat raportojnë gjatë 2011 më tepër për shqetësime që kanë të bëjnë me aspektet emocionale të marrëdhënieve intime. Ndonëse për prindërit fëmijët e tyre janë ende të vegjël për të krijuar një lidhje apo për të pëlqyer dikë të dhënat tona tregojnë të kundërtën. Vajzat e moshave të ndryshme, që nga klasa e parë e fillores deri në adoleshencë zgjedhin ALO 116 për të folur në lidhje me këtë shqetësim të tyre, çfarë tregon se për prindërit kjo temë është ende një tabu dhe e pa pranueshme. Shpesh herë fillimi i hershëm i lidhjeve dhe kontakteve seksuale, kur këto vajza janë ende të pa zhvilluara si emocionalisht, por edhe fizikisht, tregon se mbështetja dhe këshillimi me një psikolog të ALO 116 është shumë domethënës për to në këto momente specifike dhe të rëndësishme të jetës së tyre.

LLOJI ABUZIMIT	Viti 2011	LLOJI ABUZIMIT	Viti 2011
Abuzimfizik	48	Mundesipunesimi	1
Abuzimseksual	4	Ndihmëfinanciare/materiale	9
Abuzim mocional	45	Probleme me miqtë	209
Neglizhim	9	Probleme me partnerin	393
Dëshmitardhune	0	Probleme me mësuesit	69
Bulizëm	14	Problemetëtjera me tërriturit	4
Dhunënfamilje	11	Ankth i performancës	45
Punë e detyruar	13	Braktisje e shkollës	6
Punë e fëmijesnështëpi	0	Marrdhënieprind-fëmijë	208
Shfrytëzimseksual	0	Vetmi	9
Trafikim i fëmijës	0	Frike/ankth	5
Punëtëtjerratëfëmijëve	0	Vetedëmtim	0
Fëmijëtëpërdorur për lypje	0	Paragjykim	9
Fëmijë l humbur	2	Racizëm	1

Paraqitja grafike e formave të abuzimit për vitin 2011

Viti 2011





Tabela më poshtë tregon llojet më të përhapura të dhunës të ushtruar tek fëmijët vajza gjatë vitit 2012. Marrëdhënia me të tjerët, pra si me miqtë, me partnerin, por edhe me prindërit janë ndër problemet me shpesh të raportuar pranë ALO 116. Duket qartë se një ndër sfidat e çdo individi është krijimi i një marrëdhënie sociale me individët e tjerë. Çështjet personale, diferencat në karakter, por dhe në moshë, sjellin keqkuptime dhe sfida të marrëdhënies me të tjerët. Ne si qenie njerëzore kemi nevojë për vlerësim, afirmim, krijimi i një identiteti personal në shoqëri dhe që të mbajmë në harmoni botën tonë të brendshme personale me abjentin që na rethon nuk është dhe aq e lehtë. Sfidat që këto vajza kanë hasur pikërisht në krijimin e këtyre marrëdhënieve ka lindur nevojën e tyre për t'u mbështetur diku, për ta ndarë shqetësimin e tyre me dikë.

PROBLEMI I RAPORTUAR	Viti 2012	PROBLEMI I RAPORTUAR	Viti 2012
Abuzimfizik	14	Mundesipunesimi	1
Abuzimseksual	27	Ndihmëfinanciare/materiale	19
Abuzimemocional	22	Probleme me miqtë	78
Neglizhim	7	Probleme me partnerin	46
Dëshmitardhune	0	Probleme me mësuesit	27
Bulizëm	5	Problemetëtjera me tërriturit	4
Dhunënëfamilje	7	Ankth i performancës	38
Punë e detyruar	2	Braktisje e shkollës	5
Punë e fëmijesnështëpi	2	Marrëdhënieprind-fëmijë	151
Shfrytëzimseksual	1	Vetmi	3
Trafikim i fëmijës	0	Frike/ankth	20
Punëtëtjeratëfëmijëve	3	Vetedëmtim	2
Fëmijëtëpërdorur për lypje	0	Paragjykim	2
Fëmijë i humbur	2	Racizëm	2

Paraqitja grafike e formave të abuzimit për vitin 2012

Viti 2012



7. Histori dhune me bazë gjinore të raportuara në ALO 116

Jam E. nga Shkorda dhe jam 15 vjec. Kam mbaruar klasën e nëntë dhe prindërit nuk më lejuan që të vazhdoja gjimnazin pasi ata kishin frikë se mos më ngacmonin djemtë dhe mund të bëhesha vajzë e keqe.

Unë e dua shkollën pasi kam qënë një vajzë me nota shumë të mira në mësimet dhe dëshira ime ishte që unë të bëhesha dikush në jetë. Doja të bëhesha mësuese, por prindërit e mi ma thyen ëndrrën time.

Ka një javë që ata më kanë thënë se do të më fejojnë me një djal 25 vjecar, i cili jeton në Itali. Prindërit më thonë që është një rast i mirë që nuk duhet humbur pasi djali dhe familja e tij janë në gjendje shumë të mirë ekonomike ndryshe nga familja jonë e cila është e varfër.

Unë nuk dua të fejohem jam ende e vogël, unë dua të shkoj në shkollë por ata nuk më lënë. Me babin kam frikë të flas pas ai mund të më godasë nëse e kundërshtoj, por dhe me mamin nuk gjej mbështetje pasi ajo bën atë që i thotë babi.

Çfarë bëri ALO 116

Një ndër qëllimet e ALO 116 është psioko-edukimi dhe sensibilizimi i fëmijëve por edhe i prindërve të tyre.

Nuk ishte e lehtë të bindësh një adoleshente të frikësuar nga prindërit e saj që të krijojë një mundësi kontakti mes ALO 116 dhe njërës nga prindërit e saj. Pas disa bisedash me vajzën ajo pranon që këshilluesja të komunikojë me njërën nga prindërit në mënyrë të tillë që të bëhet sensibilizimi tyre mbi të drejtat e fëmijëve për arsimim por dhe detyrimet e prindërve për respektimin e kësaj të drejte.

Vajza vazhdon shkollën dhe mendon që përveç klasës së nëntë ajo të vazhdojë dhe shkollën e mesme. Mund të themi se ky është një rast pozitiv i bashkëpunimit të ALO 116 me prindërit.

Referenca

- World Report on violence and health, Etienne G.Krug,Linda L.Dahlberg, James A.Mercy, Anthony B.Zwi and Rafael Lozano, World Health organization, Geneve,2002, f. 84.
- Paulo Sergio Pinheiro, Raporti Boteror mbi Dhunen ndaj Femijeve, Organizata e Kombevete Bashkuara, Gjeneve 2006.
- Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B. (2013), Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Studimi Epidemiologjik në Ballkan mbi Abuzimin e Fëmijëve dhe Neglizhencën (BECAN), CRCA Albania, Tirana.
- Studim mbi Dhunen ndaj Vajzve, Raport i Konferencesmbi Femijet Vajza, Innocenti Research Center, 2009.
- Studimi mbi fëmijët të moshave 6-12 vjeç dhe 13-18 vjeç- Qendra e Trajtimit Multidisplinor për Problemet e Keqtrajtimit të fëmijëve (2003)
- Census 2011, INSTAT<http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>
- Të dhëna nga ALO 116<http://www.alo116.al/>

ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës I cili ofron:

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

ALO 116, si një shërbim kombëtar në ndihmë të fëmijëve, zbatohet nga CRCA Shqipëri- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijeve:



ALO 116 mbështetet dhe financohet nga:



ALO 116 ka marrëveshje bashkëpunimi me:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Avokati i Popullit
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

dhe të gjitha kompanitë e telefonisë në Shqipëri:

